

LIGJ
Nr.7637, datë 13.11.1992

PËR FLAMURIN, STEMËN, HIMNIN KOMBËTAR, FESTËN KOMBËTARE DHE
KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", të shtohet si kre më vete "FLAMURI, STEMA, HIMNI KOMBËTAR, FESTA KOMBËTARE DHE KRYEQYTETI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Neni 2

Flamuri shtetëror i Republikës së Shqipërisë paraqet një fushë të kuqe me një shqiponjë dykrenore të zezë me krahë të hapur, sipas tipit tradicional të këtij shekulli, të vendosur në mes.

Neni 3

Stema e Republikës së Shqipërisë paraqet një shqiponjë dykrenore të zezë, të vendosur mbi një shqyt (mburojë) të tipit "variaz" me ngjyrë të kuqe. Mburoja të ketë sipër një vijë të drejtë në ngjyrë të zezë, që vjen duke u ngushtuar në pjesën e poshtme. Në mburojë ka të shkruar përsipër me ngjyrë të zezë fjalët: "Republika e Shqipërisë".

Neni 4

Himni Kombëtar është Himni i Flamurit.

Neni 5

Festa Kombëtare është data 28 nëntor 1912.

Neni 6

Kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë është Tirana.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.363, datë 24.11.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha